

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -II- E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË, MBAJTUR
MË 22 SHKURT 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakele Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri, Nënkryetari i komunës z.Besim Muzaqi, komandanti i stacionit policor, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në deklarin e tij para rendit të ditës për këtë seancë me qëllim që të jep kontributin e tij dha disa vlerësime, konstatime dhe rekomandime për qeverinë komunale në përgjithësi dhe për Kryetarin e komunës në veçanti. Ai tha se në seancën e kaluar kam dhënë vërejtjet e mia lidhur me stagnimin e fillimit të procedurave në implementimin e Vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës sonë, vendim ky që është marrë nga legjislatura e kaluar dhe Kryetari Mulaku e që është dashtë të fillojë së implementuari nga data 1 janar 2018. Kam dhënë vërejtjet e mia se Zyra e Prokurimit ende nuk ka filluar asnjë aktivitet të prokurimit e me këtë kam shpreh edhe dyshimet e mia në kapacitetet e kësaj qeverie. Më vjen mirë që qeveria i ka marrë seriozisht vërejtjet e mia dhe tanimë veç ka filluar të implementojë vendimet tona të aprovuara nga legjislatura e kaluar dhe qytetarët nuk do të paguajnë më për shpenzimet e varrimit. Mirëpo në njërin pikë kemi mostransparencë totale e që është në kundërshtim të plotë me zotimet e kryetarit për transparencë dhe llogaridhënie. E kam fjalën për kontratën për kryerjen e riteve fetare të varrimit, si dhe shërbimeve dhe ceremonive përcjellëse. Në dhe qytetarët e komunës edhe tani nuk e dimë kush është caktuar projekt-menaxher i kontratës e kushte tjera të parapara konform Ligjit të Prokurimit Publik, andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat kërkoi nga Kryetari i komunës që



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -II- E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR
MË 22 SHKURT 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri, Nënkryetari i komunës z.Besim Muzaqi, komandanti i stacionit policor, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në deklarin e tij para rendit të ditës për këtë seancë me qëllim që të jep kontributin e tij dha disa vlerësime, konstatime dhe rekomandime për qeverinë komunale në përgjithësi dhe për Kryetarin e komunës në veçanti. Ai tha se në seancën e kaluar kam dhënë vërejtjet e mia lidhur me stagnimin e fillimit të procedurave në implementimin e Vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës sonë, vendim ky që është marrë nga legjislatura e kaluar dhe Kryetari Mulaku e që është dashtë të fillojë së implementuari nga data 1 janar 2018. Kam dhënë vërejtjet e mia se Zyra e Prokurimit ende nuk ka filluar asnjë aktivitet të prokurimit e me këtë kam shpreh edhe dyshimet e mia në kapacitetet e kësaj qeverie. Më vjen mirë që qeveria i ka marrë seriozisht vërejtjet e mia dhe tanimë veç ka filluar të implementojë vendimet tona të aprovuara nga legjislatura e kaluar dhe qytetarët nuk do të paguajnë më për shpenzimet e varrimit. Mirëpo në njërin pikë kemi mostransparencë totale e që është në kundërshtim të plotë me zotimet e kryetarit për transparencë dhe llogaridhënie. E kam fjalën për kontratën për kryerjen e riteve fetare të varrimit, si dhe shërbimeve dhe ceremonive përcjellëse. Ne dhe qytetarët e komunës edhe tani nuk e dimë kush është caktuar projekt-menaxher i kontratës e kushte tjera të parapara konform Ligjit të Prokurimit Publik, andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat kërkoi nga Kryetari i komunës që

sa më shpejt që të jetë e mundur të bëhet publike në ueb-faqen e komunës kjo marrëveshje apo kontratë. Te Drejtoria e Prokurimit e cila ka shpallur ofertën për pjesëmarrje në tender me titull <Hartimi i projekteve dt.19.01.2018 Nr. i prokurimit VU 644-18-121-2-2-1, Nr. i brendshëm 644-18-001-221>, kriteri i dhënies është çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme. Komuna e Vushtrrisë në këtë rast shpall hartimin e projekteve ideore dhe kryesore për ndërtime të larta dhe të ulëta, ura, parqe e të ngjashme. Hartimi i projekteve - ndërtim i lartë 9 pozicione, renovim i ndërtimit të lartë - 11 pozicione, ndërtim i rrugës - 10 pozicione, objekte hidroteknike - 9 pozicione, rregullim i shtratit të lumenjve dhe parqeve - 6 pozicione. Mirëpo te pozicioni përshkrimi i pozicioneve vërehet se sasi të nuk janë planifikuar sipas projeksioneve buxhetore dhe kemi raste të rritjes së kërkesës te një pozicion dhe mbajtje të ekuilibrit te pozicioni tjetër apo edhe zvogëlime të kërkesës te pozicione të caktuara. Krejt kjo është përgatitur që të favorizohet një operator i caktuar ekonomik dhe kjo nuk është e lejuar të ndodh, duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, i cili rastet e tilla kur tentohet të favorizohet një operator ekonomik i ka sanksionuar si diskriminim ndaj operatorëve tjerë ekonomikë dhe dëmtrim të buxhetit. Në këtë formë rrezikohet që nga buxheti, komuna të paguajë më shumë edhe në rastet kur fitues shpallet operatori ekonomik me çmimin më të ulët ekonomik, andaj kërkoi që gjatë hartimit të kërkesave nga njësia kërkuese të ketë monitorim edhe nga zyrtarët tjerë në mënyrë që të mos lejohen dëmtime buxhetore. Administratën komunale që nga ardhja e kësaj qeverie e ka përfshi një furtunë e paparë deri më tani. Sidomos kanë filluar atakimet ndaj anëtarëve dhe simpatizantëve të PDK-së, kanë filluar diferencimet politike, kanë instaluar brenda komunës mekanizma joligjor me anën e të cilave kanë filluar t'i marrin në pyetje punëtorët e administratës – formë kjo e paligjshme, kanë godit me metoda perfide personalitetin e njerëzve, duke denigruar në formën më të papranueshme, kanë godit njerëzit që kanë performancë të shkëlqyeshme nga vlerësimet paraprake dhe ky avaz po vazhdon. Bizneset kanë filluar të ngulfaten sidomos ato të hotelerisë dhe industrisë ndërtimore. Në fund kërkoi të ndërpriten këto praktika dhe vendimet diskriminuese të kthehen prapa, kurse punëtorët e administratës të lihen të qetë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – në fillim të diskutimit të tij shprehu shqetësimin e tij lidhur me një vendim të kryetarit të komunës, për caktimin e një delegacioni i cili do të udhëtojë në Suedi, ku vlerësoi se zëvendësimi i disa anëtarëve të këtij delegacioni nuk është me vend pasi që në këtë rast është përjashtuar zyrtari nga zyra ligjore, i cili ka qenë adekuat me formatin e këtij delegacioni dhe i cili ka përfaqësuar Komunën e Vushtrrisë më herët. Pastaj ceku se zyrtari i lartcekur është zëvendësuar me një zyrtar nga Drejtoria e Bujqësisë i cili nuk ka të bëjë fare me formatin e këtij delegacioni, dhe i njëjti nuk ka kurrfarë ndërlidhje me projektin në fjalë. Tutje vlerësoi se ndërrimi i këtij anëtar të këtij delegacioni dihet mirëfilli se është bërë në baza politike, ndërsa gjatë fushatës elektorale, slogan i qeverisë aktuale ka qenë depolitizimi i institucionit të komunës. Në vazhdim ai vlerësoi se në të kaluarën ka pasur shumë qeverisje (pushtet) ku të gjitha kanë pasur një fund, por ceku se pushteti aktual i ka sjellë punëtorët e administratës në një gjendje të rëndë, si rezultat i sjelljeve jo të mira të kryetarit të komunës dhe disa drejtorëve të drejtorive komunale. Mandej ai shprehu respekt për disa drejtorë të cilët nuk japin vërejtje aty ku nuk ka vend, andaj konform këtyre kërkoi nga qeveria lokale që punëtorët e administratës të lihen të qetë sepse ata nuk janë “robë e as skllavë”, por ata janë shërbesë që duhet të respektojnë ligjet dhe aktet tjera juridike në fuqi, dhe kështu të mos ketë etiketime në baza partiake pavarësisht se cilit subjekt politik i takojnë. Pastaj ceku se është i informuar se edhe qytetarët kanë opinion jo të mirë për sjellje jo korrekte të disa drejtorëve në raport me qytetarët. Lidhur me urdhëresat për kontrollin e ndërtimeve dhe lejeve ndërtimore për dy vitet e fundit, kërkoi që këto inspektime duhet të bëhen jo vetëm për dy vitet e fundit, por që nga viti 2000 duhet të kontrollohen një nga një. Lidhur me këtë çështje nuk duhet të ketë vetëm auditim, por duhet të ngritet një komision, në ç'rast duhet të involvohen edhe organet e hetuesisë dhe prokurorisë. Në kontekst të qeverisjes aktuale ai u zotua se të gjitha projektet që janë në interes të përgjithshëm si grup kuvendar do t'i përkrahin, mirëpo nuk

do të jenë përkrahës të sjelljeve të tilla të personave të caktuar. Në gjykimin e tij, por edhe nga grupi kuvendar i PDK-së, dha vlerësime maksimale për nënkryetarin e komunës, për shkak se këtë po e thonë qytetarët e jo ata, respekt maksimal për një pjesë të drejtorëve që kanë sjellje korrekte me qytetarin dhe me shërbyesit e administratës. Duke qenë të vetëdijshëm se të gjithë ne jemi vetëm shërbyes të qytetarit, duhet kuptuar se nuk jemi në funksione publike për t'u pasuruar për vete, por për të shërbyer me nder për qytetarin.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – duke iu referuar diskutimeve të parafolësve, ceku se është shumë herët të bëhen këso lloj akuza të tilla për qeverisjen aktuale, por vlerësoi se është i kuptueshëm fakti se opozita e ka përjetuar rëndë humbjen e pushtetit. Andaj lidhur me këto dhe çështje tjera i bëri thirrje opozitës në rend të parë që të jenë racional dhe të vlerësojnë mirë punën që është duke e bërë kryetari i komunë i cili është shembull për transparencën e tij, i cili në të njëjtën kohë është shembull pozitiv edhe për komunat tjera. Tutje shtoi se puna e mirë e kryetarit të komunës, shihet edhe nga përkrahja që merre nga qytetarët nëpër rrjetet sociale ku kemi vlerësime maksimale për qeverisjen aktuale të komunës. Lidhur me presonin ndaj punëtorëve të administratës të apostrofuuar nga parafolësit, ceku se nuk beson që kjo është e vërtetë dhe për këtë ai kërkoi që të kemi deklaram të rasteve konkrete e jo vetëm të flitet në mënyrë të përgjithësuar.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – deklaroi se pajtohet me diskutimet e parafolësve, dhe ceku se është mirë që këto deklarime duhet të bëhen atëherë kur i pranishëm të jetë kryetari i komunës. Tutje vlerësoi se të gjithë ne pa përjashtime e kemi gojën plotë “ligj”, por e vërteta është se veprimi i parë i kryetarit të komunës pas ardhjes në krye të komunës është heqja e fotografisë së Presidentit të Republikës së Kosovës nga zyra e kryetarit të komunës, dhe këtë e ka bërë shumë zellshëm. Lidhur me këtë është i ditur fakti se cilat komuna të Republikës së Kosovës e largojnë fotografinë e presidentit nga zyrat. Andaj kërkoi që kjo praktikë të ndalet sepse nuk mundet me qenë gjithëherë President i Kosovës i të njëjtës parti politike që e fitojnë pushtetin në komuna. Në kuadër të deklaramit për rendin e ditës ai propozoi që mbledhja e sotme të anulohet për arsye se kemi shkelje të nenit 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, andaj kërkoi nga kryesuesi që propozimi i tij të del në votim.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit – theksoi se nuk do të dëshironte të shtonte asaj që deklaruan kolegët e tij nga radhët e PDK-së, por ai referoi në dy çështje që sipas tij janë të natyrës kapitale. Me vite të tëra ky kuvend dhe Komuna e Vushtrrisë është shquar për transparencë për bashkëpunim për një vlerësim objektiv politik që nga paslufta e deri më tani. Duke e marrë për bazë faktin se kemi disa prej drejtorëve siç është ai i drejtorisë së financave i cili me vite të tëra ka shërbyer në administratën komunale dhe në qeverisjen e kryetarit Mulaku dhe të PDK-së, kurrë asnjëherë në asnjë rast nuk ka pasur vendime politike sa i përket vlerësimit dhe trajtimit të punëtorëve të administratës. Duke iu referuar anëtarit të kuvendit z.Feka se nuk kemi raste konkretet të ushtrimit të presonit ceku se rasti konkret është ai i Ilirjana Azemit, Ramiz Maliqit, Nexhat Merovcit, të cilit decidivisht i është thënë se: përgjithmonë ai do të vlerësohet me notën 1. Në relacion të krejt kësaj ai ceku se kjo qeverisje i ka vetëm dy muaj që ka filluar punë, dhe po harron që nga viti 2008 në Vushtrri ka pasur një punë të jashtëzakonshme në ndërtimin e infrastrukturës në përgjithësi e ku barrën kryesore e ka pasur pikërisht Drejtoria e Urbanizmit, dhe punëtorët e saj që për 20 vite këta shërbyes kanë bërë shumë punën në terren e të cilën komuna asnjëherë nuk ka mundur t'iu shpërblejë ashtu siç duhet këtë punë aq të madhe. Andaj këta punëtorë kaq të zellshëm të goditen në këso forma mbi baza politike pa asnjë vlerësim dhe të dislokohen në drejtori tjera pa asnjë arsytim, kjo është për keqardhje. Lidhur me të gjitha këto grupi kuvendar i PDK-së si grupi më i madh politik nuk do të rri duarkryq, dhe të tolerojë këso lloj veprimesh shkatërruese ndaj administratës ku po tentohet që administratën të vejnë nën ndikimin e veprimeve shantazhuese dhe të pengimit në kryerjen e detyrave të tyre. Barra e investimeve në Drejtorinë e Urbanizmit kap vlerën e 100 milion euro që janë investuar në komunën tonë, janë ndërtuar mbi 400 km rrugë, 300 km rrugë me kubëza dhe shumë projekte tjera dhe zyrtarët e kësaj drejtorie e kanë pasur barrën kryesore të përgjegjësisë për realizimin e

këtyre projekteve, dhe tani pa asnjë fakt të goditen këto personalitete, kjo është e papranueshme. Andaj lidhur me këtë dhe çështje të tjera ai kërkoi nga Lidhja Demokratike dhe Lëvizja Vetëvendosje që publikisht të distancohen nga këto praktika. Tutje ai vlerësoi se frymën e kulturës politike që e ka ndërtuar PDK në institucionin e komunës nuk duhet rrënuar. Pastaj ceku se me të ardhur në pushtet është hequr fotografia e Presidentit të Kosovës nga zyra e kryetarit të komunës, dhe kjo nuk i shërben askujt. Nëse qeveria aktuale vjen me projekte atëherë secilin anëtar të kuvendit do ta keni prapa në mbështetje të fuqishme, por jo me këso lloj veprimesh. Lidhur me çështjen e urbanizmit nuk do të prononcohet pasi që këtë do ta bëjnë në një mbledhje tjetër të radhës, pasi që të përfundojnë “hetimet”, të cilat i ka filluar drejtori aktual i Drejtorisë së Urbanizmit. Vlerësimet që janë bërë nga Drejtoria e Inspektiveve, lidhur me ndërtimet është konstatuar se gjithçka ka shkuar sipas rregullave, por për çudi këtyre vlerësimeve nuk iu është besuar dhe për këtë është kontraktuar një kompani për të bërë rivlerësim. Lidhur me krejt këtë ai kërkoi nga kryetari i komunës që praktikat e tilla të ndalen dhe të fillohet me projekte konkrete, të cilat janë premtuar gjatë fushatës paraelektorale.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – pasi i lartësoi dhjetëra mijëra heronj dhe dëshmorë të kombit, të cilët dhanë gjithë çfarë patën për lirinë e Kosovës, të gjithë anëtarëve të kuvendit iu uroi jubileun e parë të Republikës së Kosovës. Tutje tha se nuk di se si ndryshe të fillojë diskutimin e tij përpos që të falënderojë qindra qytetarë të cilët e kanë votuar në zgjedhjet e fundit lokale. Pastaj vlerësoi se kur ka marrë barrën e përgjegjësisë për t’u kandiduar për anëtar të kuvendit e ka pasur për bazë peshën e përgjegjësisë për t’u ballafaquar me problemet sy me sy, për t’u ballafaquar me problemin emergjent. Pastaj shtoi se fshati Maxhunaj, për shkak të pozitës gjeografike dhe relievit që ka, bën që shumë ujë të zbrazet sidomos në tri apo katër shtëpi dhe atë në shtëpitë e Kadri, Shukri e Mehdi Maxhunit dhe për këtë problematikë i kanë parashtruar kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Publike për të intervenuar për rregullimin e këtij problemi, por përgjigjja e tyre ka qenë prej dy fjalëve refuzohet kërkesa. Në këtë kontekst vlerësoi se është shumë e lehtë të refuzohen njerëzit, por është shumë e vështirë të ndihmohen ata. Tutje shtoi se qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe jo të trajtohen në mënyrë fyese dhe denigruese siç ishte rasti me banorët e fshatit Maxhunaj, andaj kjo sipas tij është e papranueshme. Në vazhdim ai vlerësoi se që dy muaj prej se kjo qeveri ka marrë mandatin nuk ka idenë dhe nuk e di se cilat janë politikat afatshkurta, ato afatmesme dhe afatgjate, për këtë ai kërkoi që kryetari i komunës të vjen dhe të ballafaqohet me problemet reale të qytetarit. Qeverisja aktuale nuk është ajo e Lidhjes Demokratike dhe e popullit demokratik, por është qeverisje kryeneçe e kryetarit të komunës, i cili linçon dhe shantazhon me kërcënim për largim nga puna punëtorët e komunës dhe kjo gjë është e papranueshme. Në kontekst të kësaj ai bëri të ditur se qytetarët, punëtorët e administratës, si dhe anëtarët dhe simpatizantët e PDK-së nuk janë vetëm, dhe se sipas tij nëse dikush mendon ndryshe atëherë e ka shumë gabim. Mandej vlerësoi se PDK dhe LDK janë dy shtëpi politike të kundërta, por të cilat kanë bashkëjetuar shumë mirë në të kaluarën, andaj sjelljet e tilla arrogante, dhe prepotente janë të patolerueshme. Në fund ai duke pohuar Konicën i cili në një kohë tjetër e që vlen enkas për qeverisjen aktuale thoshte < para se njeriu të merret me politikë ai duhet të edukohet dhe duhet të emancipohet >.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - njoftoi se kryetari i komunës, ndodhet në një takim me zëvendësambasadoren e SHBA-ve, për atë shkak nuk gjendet në mbledhjen e kuvendit, andaj në ndërkohë ai do t’i bashkëngjitet mbledhjes dhe do të prononcohet lidhur me kritikën e bëra nga ana e opozitës, kurse ai si kryesues i kuvendit nuk e ndjen veten kompetent të jap përgjigje për çështje që u ngritën nga anëtarët e kuvendit, por kjo nuk nënkupton se ai pajtohet me kritikën e bëra.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se është i papranueshëm fjalori dhe gjuha e përdorur nga ana e opozitës që e atakon qeverinë dhe kryetarin e komunës, për faktin se është i patolerueshëm dhe i paqëndrueshëm fakti që një doktor i shkencës siç është kryetari i komunës të quhet njëri i paedukatë. Tutje shtoi se kjo qeveri e ka marrë vetëm që dy muaj mandatin dhe

nuk mundet për kohë të shkurtër t'i zgjedhë të gjitha problemet të cilat nuk janë zgjedhur për dhjetë vitet e kaluara nga qeveria e kaluar. Shembulli më mirë për fillim të mbarë të qeverisjes së mirë është transparenca e plotë e kryetarit të komunës. Sa i përket akuzave për preson ndaj punëtorëve të komunës, ceku se nuk beson që kjo është e vërtetë, kurse për ndërrimin e vendeve të punës së punëtorëve të administratës, për këtë ekzistojnë mekanizmat ligjor dhe ata mund të ankohen të vlerësojnë se kemi të bëjmë me shkelje të drejtave të punëtorëve.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se nuk mund të përgjigjet për akuzat e bëra nga opozita, për shkak se nuk e dinë gjendjen faktike, dhe shtoi se qeverisjen dhe konfiguracionin aktual politik të komunës sonë e ka votuar qytetari i Vushtrisë, dhe për këtë e kanë besimin nga qytetari dhe për këtë besim të dhënë ata do të jenë shumë të sigurtë. Tutje apeloj që të gjitha strukturat politike të përfaqësuara në kuvend duhet të kenë një unitet, ndërsa ankesat kur të bëhen ato duhet të jenë reale dhe të argumentuara. Mandej ai përsëriti dhe apeloj që të jenë të gjithë kompakt dhe unik dhe të shmangët gjuha e urrejtjes ndaj njëri tjetrit. Gjithashtu ai ceku se nuk duhet të ketë tendenca ndaj njëri tjetrit dhe vlerësoi se gjithëherë kur punohet edhe mund të ketë gabime, por është shumë më e lehtë përgjegjësia atëherë kur gabimet ndodhin pa qëllim të caktuar. Lidhur me gjendjen në infrastrukturë ai vlerësoi se të gjitha projektet nuk mund të bëhen për një kohë kaq të shkurtër pasi që duhen investime dhe punë e madhe dhe për këtë duhet prituri.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – tha se drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve, është duke bërë një punë shumë të mirë, dhe për këtë beson se të gjithë pajtohen. Tutje shtoi se lufta mes opozitës dhe pozitës është gjë e shëndetshme, por kuptohet se kjo luftë duhet të bëhet mbi bazën e argumenteve. Lidhur me qeverisjen aktuale ai ceku se është një start i mirë dhe koha do të tregojë se si po qeveriset komuna, në fund të fundit gjithçka vlerësohet e edhe kjo qeveri do të vlerësohet nga ana e qytetarit. Kritikën e bëra nga ana e opozitës nuk beson se qëndrojnë dhe se dihet se ndryshimet bëhen vetëm me punë, dhe puna mbetet të shihet në të ardhmen.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit – tha se drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve është duke bërë një punë të mirë, por atij drejtori dhe stafit të tij duhet t'i besohet, dhe jo tash të angazhohen kompani private për rivlerësim të punës dhe kështu të dalim jashtë suazave të institucionit.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë së Administratës – kërkoi që të bëhet sqarim mes Drejtorisë së Administratës dhe administratës komunale në tërësi ashtu që mos të krijohet konfuzitet, por të specifikohet se në cilin dikaster komunal ka pasur qoftë preson apo diferencim politik të zyrtarëve komunal, për faktin se administrata komunale është koncept shumë më i gjerë se sa Drejtoria e Administratës.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - dha sqarime lidhur me rendin e ditës, si dhe propozoi pikat shtesë në të ndryshme duke arsyetuar se këto pika kanë ardhur si rezultat i kohës së kufizuar dhe administrata e kuvendit ka bërë përpjekje maksimale për respektimin e afatit ligjor për dërgimin e materialit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se nuk duhet që anëtarët e kuvendit të sillen para dilemave se për çfarë po votojnë dhe në këtë rast kërkoi që mbledhja e kuvendit të shtyhet për shkak se nuk kemi respektim të afatit ligjor që del nga Ligji për Vetëqeverisja Lokale. Mandej vlerësoi se edhe mbledhja e komitetit është mbajt në kundërshtim me ligjin, për shkak se vendimi për themelimin e KPF-së është kontestuar nga ministria e linjës. Po ashtu edhe propozim-vendimi për themelimin e KKSB-së, është vendosur në komitet që të procedohet nëse plotësohen kushtet ligjore, e që në rastin konkret ato nuk janë plotësuar andaj kërkoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës. Gjithashtu dha vërejtje edhe sa i përket propozimit për themelimin e komisionit për ankesa sa i përket dhënies së pronës në shfrytëzim pasi kjo pikë është dashur të vjen si pikë e rregullt e rendit të ditës, me qëllim që grupet politike të bëjnë konsultimet e nevojshme lidhur me emrat që do të jenë pjesë e këtij komisioni, andaj edhe për këtë kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – përsëriti se është evidentet se po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale, dhe kërkoi që kjo praktikë të ndërpritet. Tutje lidhur me propozim-

vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, vlerësoi se është keq që pikat me kaq shumë rëndësi për komunën dhe qytetarin të vijnë shpejt e shpejt pa u analizuar fare dhe në pikën në të ndryshme ato të votohen. Pastaj shtoi se dhënia e pronës për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, është çështje kapitale për komunën dhe nëse dikush mendon që kjo punë të përfundohet në procedurë të përshpejtuar dhe pa e analizuar si duhet, atëherë kjo është shumë gabim.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se duhet bërë përpjekje që materialet për mbledhje të kuvendit të vijnë me kohë, dhe mos të kemi pika në të ndryshme. Pastaj lidhur me emrat për komisionet e ndryshme që do të themelohen për këtë do mund të konsultohen në pauza gjatë mbledhjes. Gjithashtu bëri të ditur se edhe mandatin e kaluar ka pasur probleme sa i përket emrave të KPF-së, por edhe lidhur me kuotën gjinore e cila ka qenë 30%.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – fillimisht tha se është e papranueshme gjuha e përdorur nga ana e opozitës, qysh në mbledhjet e para të këtij mandati qeverisës, për faktin se ata si LDK asnjëherë në të kaluarën nuk kanë përdorur një gjuhë të tillë. Përdorimi i kësaj gjuhe fyese po bëhet për shkak të inateve personale dhe politike dhe për asgjë tjetër. Pastaj informoi se në të kaluarën me dhjetëra herë e kanë marrë materialin e kuvendit me vonesë dhe asnjëherë nuk është kërkuar anulimi i mbledhjes. Disa herë në të kaluarën në pikën në të ndryshme kanë ardhur deri një dhjetë pika dhe asnjëherë nuk është reaguar në mënyrë kaq të ashpër. Lidhur me këtë ai pyeti se përse gjithë kjo ashpërsi nuk e kupton, apo ndoshta për faktin se disa anëtarëve të kuvendit iu është vonuar lëshimi i lejes ndërtimore, apo edhe ndoshta se disa anëtarë kanë pasur konflikt interesi në një donacion në çerdhen e qytetit. Andaj për të gjitha këto ai kërkoi që ndalohet përdorimi i kësaj gjuhe të ashpër, të ulen gjakrat dhe të futet fryma e bashkëpunimit. Në fund tha se tani ndryshimet kanë ndodhur dhe këtë e ka vendosur qytetari, andaj duhet pritur të ardhmen për të shikuar se si po qeveriset komuna.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se mund t'i sigurojë që të gjithë e veçanërisht anëtarin e kuvendit z.Gërgurin, që asnjëherë auditori i përgjithshëm nuk ka dhënë rekomandim ku përmendet emri i tij, apo emri i kompanisë për të cilën po pretendohet. Dhe për këtë nëse gjenden materiale zyrtare që e implikon emrin e tij, atëherë do të kërkojë falje publike. Në të kundërtën anëtari i kuvendit Hysni Gërguri publikisht duhet të kërkojë falje për shpifjet e bëra. Në të vërtetë lidhur me këtë çështje ka pasur debat lidhur me një aktivitet të prokurimit ku zyra e prokurimit ka kërkuar interpretim ligjor se a ka konflikt interesi dhe përgjigja ka qenë se ka konflikt interesi dhe procedura nuk ka shkuar më tutje dhe për këtë ju keni harruar. Tutje shtoi se përkundër respektit që gëzon për z.Gërgurin ai duhet të jetë i matur kur bën këso lloj akuzash publike dhe të pabazuara sepse po thirret në raport të auditorit. Në fund ai kërkoi që për mbledhjen e ardhshme të sillen materialin e auditorit që e implikon emrin e tij për konflikt interesi, në të kundërtën anëtari i kuvendit z. Gërguri duhet të kërkojë falje publike.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar LVV-së, kërkoi që respektohet minutazha në diskutime dhe njoftoi se pajtohet me rendin e ditës me përjashtim të pikave në të ndryshme, për të cilat iu duhen konsultime shpesh, dhe për këtë ajo propozoi që të vazhdohet me procedimin e rendit të ditës.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që të respektohet rregullorja e punës e kuvendit, dhe mos të kemi stërzgjatje të diskutimeve, por të kalohet me procedimin e rendit të ditës.

Pas debatit lidhur me rendin e ditës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me 24 vota “për” 9 vota “kundër” 2 vota “abstenim” aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.01.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017;
3. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa Nr. 01.23/18, i datës 25.01.2018;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve;
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen në shëndetësi;
9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018;
10. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi;
 - b). Shqyrtimi i propozimit për formim të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
 - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formim të Komisionit për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
 - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës i datës 25.01.2018

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – paraqiti vërejtjet e tij sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e të cilat janë inkorporuar në procesverbalin e mbledhjes të datës 25.01.2018.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LVV-së, tha se diskutimi i anëtares së kuvendit znj. Gresa Muli është devijuar paksa, andaj kërkoi që kjo të përmirësohet.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit – tha se sa i përket pikës së parë personalisht si anëtare e Kuvendit në seancën e kaluar ka qenë hera e parë që kam dal në këtë foltore për të folur dhe ajo çka unë kam thënë atë ditë ka marrë një tjetër kaheje kur është shkruar në procesverbal. Pas kërkesës të shefes së grupit tonë kuvendar, që t'iu flas për funksionin e grupit joformal të grave unë kam propozuar që ky grup joformal të funksionalizohet dhe t'i ndahet një fond me të cilin duke bashkëpunuar si grup mund ta financojmë ndonjë projekt apo aktivitete që u ndihmon kategorive të ndryshme të grave të Komunës së Vushtrrisë. Në asnjë mënyrë këtë fond nuk e kam paraparë për adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me gratë anëtare të kuvendit (ashtu siç është shkruar në procesverbal). Normalisht që grupi joformal i grave merret edhe me aktivitete të cilat nuk janë të ndërlidhura vetëm me fond dhe të cilat shpesh shtyjnë çështje edhe në të mirë të grave anëtare të kuvendit, mirëpo për këtë gjë nuk është i nevojshëm fondi. Kam informata se në mandatin e kaluar ky fond është planifikuar të shfrytëzohet për një vizitë në Turqi të grave anëtare të Kuvendit dhe sigurisht që në këtë mandat propozimet e tilla qesharake as nuk do të lejojmë të shqyrtohen sepse ne jemi këtu në shërbim të qytetarëve dhe si përfaqësuese të tyre duhet të bëjmë të pamundurën që edhe sikur mos të kemi fonde fare të gjejmë mënyrën t'iu ndihmojmë atyre dhe në asnjë mënyrë të mos i ofrojmë vetes komoditetin

sa të mendojmë që këtë fond apo çfarëdo fondi ta shfrytëzojmë për nevojat tona si anëtare të Kuvendit. Andaj e lus personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit që të korrigojë fjalinë time në procesverbalin e seancës së kaluar në mënyrë që të aprovohet më pas edhe nga ana jonë.

Melihate Basholli - Latifi - kërkoi që të përmirësohet diskutimi i saj në procesverbal faqe numër 10 duke u shtuar fjalia: se në të kaluarën ka ekzistuar grupi joformal i grave anëtare të kuvendit. Mandej sqaroi se nuk bëhet fjalë për vizitë private dhe personale në shtetin e Turqisë të grupit të grave, por bëhet fjalë për vizitë zyrtare të shkëmbimit të përvojave.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.01.2018, me vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se duhet të përmirësohet emërtimi i kësaj pike të rendit të ditës për faktin se nuk bëhet fjalë për raport të policisë, por për informatë e cila ofrohet para kuvendit. Ai kërkoi nga policia, por edhe nga Sekretaria e Kuvendit që në ardhmen mos të lëshohen këso gabimesh.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se mbetet shqetësuese shifra e dyfishuar e përdorueseve të substancave narkotike, ajo e dyfishimit të aksidenteve, si dhe dyfishimi i veprave penale vjedhje të rënda, për këtë pyeti se cilat janë masat që do të ndërmerren me qëllim të parandalimit të këtyre akteve.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit – tha se pasi që mbledhja e kuvendit ndiqet përmes mediave lokale dhe me qëllim të informimit të qytetarëve, është mirë që ky raport të sqarohet në pika kryesore dhe nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët e kuvendit për to do të mund të ofrohen përgjigje nga komandanti i policisë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se nga raporti i policisë shihet se kemi rritje të numrit të veprave penale. Rastet e përdorimit të narkotikëve kanë pësuar rritje (janë dyfishuar), vjedhjet e rënda dhe tentim vjedhjet janë raste që kanë shënuar më së shumti ngritje. Përkundër të gjitha këtyre fakteve në raportin e policisë thuhet se gjendja e sigurisë është e kënaqshme, por në të vërtetë nuk është e kënaqshme sipas tij dhe për këtë duhet punë efektive që siguria e qytetarëve të jetë në nivel të duhur dhe qytetarët të ndihen të sigurt në ushtrimin e veprimtarive të tyre. Si anëtar i kuvendit në fillim të këtij viti ka marrë një informatë e pikës së karburanti e quajtur “Sllovenia Petrol” në fshatin Stanoc i Epërm se gjatë muajit nëntor-dhjetor të vitit të kaluar kjo pikë është sulmuar nga persona të maskuar dhe të armatosur dhe nën kërcënimin me armë kjo kompani është plaçkitur dhe kështu është rrezikuar jeta e punëtorëve të asaj kompanie. Duke mos u ndje të sigurt shtatë (7) punëtorë të kësaj kompanie kanë lëshuar punën. Lidhur me këtë ai uroi që këso rastesh të mos të kemi në të ardhmen, kërkoi nga organet e sigurisë që t’i shtojnë patrullat në pikat e karburanteve me qëllim që rastet e tilla të parandalohen.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit – tha se në raportin policor për gjendjen e sigurisë është parë që rritja e numrit të përdoruesve të narkotikëve është dyfishuar, fatkeqësisht kjo rritje është bërë në proporcion të drejtë me përdoruesit nën moshën 18 vjeçare, njëri prej vendeve ku përdoren narkotikët janë edhe institucionet shkollë sidomos në ato të mesme të larta. Personalisht gjimnazin e ka përfunduar që një vit, dhe gjatë atyre 3 viteve kontroll ka pasur vetëm njëherë nga policia civile. Ajo e sheh të rrugës që numri i kontrolleve në shkolla e mesme të larta të rritet dhe ligjërata të mbahen në mënyrë periodike të rregullt.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se pakënaqësitë politike duhet të paraqiten në mënyrë më të kulturuar, e jo që të ofendohemi njëri me tjetrin. Tutje shtoi se nga raporti i policisë del se gjendja e sigurisë nëpër shkolla nuk është e mirë dhe kjo është mjaft shqetësuese. Për këtë

pyeti se Drejtoria e Arsimit a është e informuar për gjendjen në shkollat e komunës dhe se cilat masa është duke i ndërmarrë. Në vazhdim ai vlerësoi dhe u zotua se do të jetë në shërbim të drejtorit të arsimit dhe të kryetarit të komunës që të punojnë së bashku më qëllim të parandalimit të rasteve të përdorimit të substancave narkotike dhe në përgjithësi për ngritjen e nivelit të sigurisë nëpër shkolla. Mandej ai ceku se nga burime jozyrtare thuhet se përdorimi i parë i narkotikëve nga nxënësit bëhet në ekskursionet në Shqipëri, andaj për këtë kërkoi që bashkërisht të rishikohen udhëzimet administrative për anulimin e vizitave në Shqipëri, për faktin se këto vizita nuk paraqesin ndonjë atraksion për banorët e Republikës së Kosovës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit – tha se e ka lexuar me vëmendje raportin për gjendjen e sigurisë për vitin 2017. Më vjen mirë që në raport është përmendur edhe siguria e nxënësve nga qentë endacakë sepse ky problem nuk është vetëm tek shkolla “Naim Frashëri”, por është në përgjithësi në Komunën e Vushtrrisë, në fshatra dhe sidomos në rrugën “Dëshmorët e Kombit” afër shkollës fillore “Ali Kelmendi”. Unë desha të flas pak për sigurinë e nxënësve nga automjetet, saktësisht për nxënësit e fshatit Sfaracak, të cilët vijnë në mësimin në shkollën fillore të fshatit Nedakoc. Për fat të keq këta fëmijë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë janë të detyruar që çdo ditë të kalojnë magjistralen për të shkuar dhe kthyer nga shkolla. Të gjithë e dimë se sa i rrezikshëm është ai udhëkryq në të cilin kanë ndodh shumë aksidente. Prej se unë kam vijuar mësimin në atë shkollë fillore është përfolur për një zgjidhje të këtij problemi, qoftë me nënkallim apo mbikalim, por ende nuk është ndërmarr diçka dhe kjo nuk është kompetencë e nivelit lokal. Para disa vitesh në këtë vend gjatë kohës kur nxënësit kanë shkuar dhe janë kthyer nga shkolla kanë qenë të siguruar nga policia, të cilët kanë qenë aty me kërkesë të prindërve dhe mësimdhënësve. Pas një kohe ata policë kanë ndaluar së ardhuri dhe nxënësit prapë çdo ditë i kanë rrezikut nga automjetet, kështu që këtë informatë e ka edhe drejtori i arsimit z. Afrim Namani, i cili në atë kohë ka qenë drejtor në atë shkollë. Në fshatin Sfaracak përpos problemeve tjera si: mungesa e sistemit të kanalizimit, mungesa e trotuareve etj., të cilat nga qeverisja e kaluar nuk kanë pas ndonjë zgjidhje dhe që nuk vlen të përmenden në këtë pikë ky problem është shumë i rëndësishëm. Unë si përfaqësuese e këtij fshati në Kuvendin komunal kam bërë kërkesë te nënkryetari dhe drejtori i shërbimeve publike që të shikojnë për mundësinë që ky vendkalim i rrezikshëm të jetë përsëri i siguruar nga policët, të paktën gjatë kohës kur nxënësit shkojnë dhe kthehen nga shkolla. Nënkryetari me ka njoftuar se ka marrë konfirmimin nga ju se ai vend tash e tutje do të jetë i siguruar nga policët, mirëpo mua personalisht nuk më ka rastisur që ata policë t’i shoh në atë vendkalim dhe nga banorët e fshatit kam marrë informata se policët kanë dal vetëm dy ose tri ditë dhe jo më shumë. Unë kam informatë për mungesën e policëve që e kemi në Komunën e Vushtrrisë, mirëpo nuk mendoj se kjo çështje është e parëndësishme dhe e cila vlen të lihet anash sepse po bëhet fjalë për sigurinë e fëmijëve tanë, prandaj unë edhe përmes Kuvendit iu lus në emër të banorëve të fshatit Sfaracak që të merrni masa sa i përket kësaj çështjeje. Unë këtë kërkesë e kam të përpiluar edhe në formë të shkruar me nënshkrime të secilit prind, të cilën kërkesë nëse është e nevojshme mund ta sjell edhe tek ju.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit – tha se është e papranueshme gjuha politike që u përdor në fillim të kësaj mbledhjeje, ndërsa për gjendjen e sigurisë kërkoi mobilizim të përgjithshëm që ajo të jetë sa më e mirë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se prej se e ka marrë mandatin si kryetar i komunës, ka themeluar një bashkëpunim të mirë me komandantin e stacionit policor dhe me strukturat e policisë në Komunën e Vushtrrisë. Tutje vlerësoi se gjendja e sigurisë në komunën tonë gjatë vitit 2017 për fat të keq ka degraduar, porse për këtë të gjithë kemi obligime që bashkërisht të punojmë për ngritjen e nivelit të sigurisë në komunën tonë. Pastaj njoftoi se është dakorduar me komandantin e stacionit policor dhe me drejtorin regjional të Policisë së Kosovës që të ndërmerren masa konkrete në rritjen e sigurisë edhe në shkolla e edhe në qytet, por edhe rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e pasurisë të qytetarëve tanë. Është shqetësuese fakti se kemi rritje të numrit të veprave penale të vjedhjeve dhe vjedhjeve grabitqare sepse pasuria e qytetarëve nuk

është e sigurt, kurse është tepër shqetësues niveli i përdorimit të drogës dhe i substancave tjera narkotike në qytetin tonë e sidomos nëpër shkolla. Lidhur me këtë tha se duhet të kemi një mobilizim të përgjithshëm që nga ai si kryetar i komunës, pastaj strukturat policore dhe të gjithë të zgjedhurit në Kuvendin e komunës. Në vazhdim ai shtoi se kur kemi të bëjmë me çështje të natyrës kapitale siç janë fëmijët tanë, atëherë duhet t'i tejkalojmë suazat partiake dhe bashkërisht t'i ndërmarrim të gjitha ato masa që janë të nevojshme në mënyrë që të përmirësohet niveli i sigurisë. Lidhur me masat që do të ndërmerren do të bëhen analiza adekuate që të bëhet qoftë rritja e numrit të policëve civilë nëpër shkolla apo rritja e buxhetit ose duke rritur aktivitetet vetëdijesuese. Në këtë kontekst njoftoi se tani ka filluar një projekt në bashkëpunim me Qendrën kosovare për edukim që ka për objektiv aftësimin e mësimeve për të zgjedhur konfliktet nëpër shkolla. Mandej si kryetar i komunës ka udhëzuar njërin nga drejtoritë e ekzekutivit që të bëjë analizë për numrin e rasteve që kemi për secilën kategori në mënyrë që pastaj t'i përshtatemi politikat komunale për t'i adresuar problematikat që i shohim, nëse kemi rritje të numrit të përdorueseve të narkotikëve, atëherë vitin e ardhshëm do të mbështesim me subvencione OJQ-të që merren me vetëdijesim kundër substancave narkotike, nëse kemi më tepër raste të vjedhjeve dhe dhunës nëpër shkolla do të subvencionohen OJQ-të që merren me aktivitete për ngritjen e vetëdijes për parandalimin e dhunës nëpër shkolla dhe ngritje të sigurisë. Kjo është mënyra se si bëhen politikat komunale dhe këtë qasje e ka pasur që nga fillimi bashkërisht me komandantin e policisë. Në fund tha se në të ardhmen do të ketë një vigjilencë më të madhe dhe është i bindur se gjatë vitit 2018 do të shënojë përparim në gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Komunën e Vushtrrisë.

Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim - paraqiti sqarime sa i përket gjendjes së sigurisë nëpër shkolla dhe dha përgjigje në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit – tha se bashkëpunimi në mes strukturave policore dhe atyre komunale duhet të intensifikohet edhe me tutje, me qëllim të ngritjes të nivelit të sigurisë për qytetarët tanë. Mandej vlerësoi se serveri i kamerave që ndodhet në objektin e komunës duhet në bartet në objektet e stacionit policor, ashtu që të mund të monitorohet qyteti e veçanërisht shkollat, në të cilat ka informacione se konsumohen substanca narkotike. Lidhur me sfidat të cilat cekën në raport askund nuk përmendet trajtimi i qenve endacakë, të cilët po paraqesin rrezik permanent sidomos për fëmijët në orët e hershme të mëngjesit. Për këtë apeloj tek kompetentët, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe operatori kontraktues që këtë çështje ta marrin më shumë seriozisht.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – njoftoi kuvendin se ekziston një projekt nga niveli qendror në vlerë mbi 1 milion euro, për trajtimin e qenve endacakë në gjithë territorin e Kosovës, për faktin se ky është një problem që nuk mund të trajtohet nga komuna në komunë. Ajo që po ndodh për fat të keq është se qentë endacakë po barten nga njëra komunë në tjetrën nga operatori ekonomik që ka për obligim të merret me këtë problematikë pa i trajtuar fare. Andaj duke qenë në pamundësi të kontrollimit të kësaj dukurie, është shumë problematike që një komunë të trajtojë këtë problematikë në mënyrë adekuate. Ky projekt nga niveli qendror besojmë se do ta zbusë këtë problem pasi që me këtë çështje do të merret Agjencia Nationale e Veterinarisë dhe Ushqimit, ku do t'i angazhojë veterinerët në çdo komunë për t'i trajtuar qentë endacakë në mënyrë të organizuar. Problematika tjetër në regjionin tonë është se mungon një strehimore për trajtimin e qenve endacakë. Gjithashtu ai paraqiti edhe një informatë para anëtarëve të kuvendit, duke shtuar se në bazë të kontratës për një qen endacak Komuna e Vushtrrisë paguan 33 €, kurse për të njëjtën çështje Komuna e Drenasit paguan 28 €, dhe është shumë keq që ne si komunë kemi 0 € për lindjen e një foshnjeje dhe kjo është shumë keq. Lidhur me këtë problematikë ai vlerësoi se askush nuk mund të merr merita e as lëvdata edhe të themi se e kemi zgjedhur problemin sepse vetëm një komunë nuk mund ta zgjidhë këtë problem. Në fund tha se kjo çështje është mjaft komplekse, për këtë ai ka kërkuar nga Drejtoria e Emergjencës që ta rrit vigjilencën dhe ceku se realiteti është se me këtë çështje në të kaluarën është abuzuar dhe kontraktimi për marrjen e këtyre shërbimeve është bërë më shtrenjt

krahasuar me komunat tjera. Drejtoria e Emergjencës ka filluar bashkëpunimin me kompaninë kompetente dhe ditëve të fundit janë trajtuar rreth 120 qenë endacakë, por numri i tyre është duke u rritur nga dita në ditë, por për këtë duhet të ketë një strehimore.

Muhamet Alidema, komandant i stacionit policor - paraqiti sqarime lidhur me gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit – tha se çështja e narkomanisë është çështje shumë e ndjeshme, tutje shtoi se ai njeri që e përdor drogën, ai do të ketë pasoja për tërë jetën. Pastaj ceku se nuk duhet fajësuar policinë e as strukturat e arsimit, por duhet të rritet bashkëpunimi mes të gjitha organeve me qëllim të parandalimit të përdorimit të substancave narkotike. Prindërit duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe të mbikëqyrin fëmijët e tyre në aspektin e mirërritjes dhe edukimit. Mandej ai apeloi tek organet e sigurisë që të bëjnë hulumtimet e duhura që t'i bie në gjurmë atij grupi i cili merret me shitblerjen e këtyre drogave.

Muhamet Alidema, komandant i stacionit policor - tha se policia, njësi antidrogë i ka shtuar aktivitetet e tij për parandalimin dhe zbulimin e grupeve dhe individëve që merren me shitblerjen e drogave të ndryshme .

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – kërkoi nga policia, që të ndërmerren masa adekuate që të pengohet parkimi i veturave në rrugë në “Lagjen e Badiukëve”, për faktin se parkimi joadekuat i tyre e ka ngushtuar tej mase rrugën dhe kështu po shkaktohet rrezik për këmbësorët.

3.Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të komunës lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa Nr. 01.23/18, i datës 25.01.2018

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së, kërkoi që të respektohet opinioni ligjor i MAPL-së, që të respektohen dispozitat ligjore të Ligjit për Barazi Gjinore. Pastaj kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që bëjë interpretim ligjor në Ministrinë e Pushtetit Lokal, lidhur me çelësin e përbërjes së KPF-së, pasi që mendon se ajo përbërje është e padrejtë, në ç’ rast janë dëmtuar si subjekt politik ku kanë një anëtar më pak në komitet. Në të kundërtën e kësaj ata do të parashtrajnë ankesë në ministrinë gjegjëse e cila është kompetente për vlerësimin e ligjshmërisë. Tutje duke iu referuar ligjit dhe udhëzimit administrativ, tha se përfaqësimi në Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të jetë konform numrit të ulëseve që ka marrë një subjekt politik në kuvendin e komunës. Në fund tha se nëse nuk respektohet kërkesa e grupit kuvendar të PDK-së ata nuk do të marrin pjesë në mbledhjet e KPF-së.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – kërkoi që vendimi për themelimin e KPF-së të mbetet ashtu siç është votuar pasi që është shumë e vështirë të respektohet kuota gjinore prej 50 %.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se edhe më herët nuk ishin pajtuar me përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe shtoi se në mbledhjen e kaluar ishin pajtuar në parim me kusht që t'i drejtohet MAPL-së me kërkesë për interpretimin e çelësit që është votuar për themelimin e KPF-së, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Andaj është detyrë e kryesuesit të kuvendit që të kërkojë nga MAPL- interpretim ligjor se grupit kuvendar të PDK-së i takojnë 2 apo 3 anëtarë në KPF.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - tha se në mbledhjen e kaluar përbërja e KPF-së është aprovuar në mënyrë unanime dhe se vlerësimet që i ka bërë MAPL-ja, nuk kanë të bëjnë me numrat dhe as me përbërjen e komitetit, porse vendimi është kontestuar në aspektin gjinor, andaj nëse dikush ka propozim për ndryshimin e kuotës gjinore, atëherë le të bëhet propozimi dhe kuvendi e aprovon këtë ndryshim.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se e drejta ekziston në anën e PDK-së, sepse grupi i jonë ka bërë kompromis dhe në aspektin legal dhe gjinor jemi në rregull. Vlerësimet e ministrisë kanë të bëjnë me kontestimin e vendimit në aspektin gjinor. Pastaj shtoi se i takon

subjekteve tjera politike që propozojnë emra të ri me qëllim të respektimit të kuotës gjinore sa i takon përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se nuk ekziston konstatimi se grupi kuvendar i PDK-së është pajtuar me përbërjen e KPF-së, por se ata nuk kanë dashur që të jenë bllokues të këtij procesi. Votimi në mënyrë unanime është bërë me kusht që të kërkohet interpretimi ligjor nga ana e MAPL-së lidhur me këtë vendim. Kryesuesi i kuvendit nuk ka parashtruar kërkesë dhe kjo çështje ka mbetur pezull. Në fund ai përsëriti se grupit kuvendar të PDK-së i takojnë tri ulëse në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se LB-ja nuk kërkon lëmosh nga askush kur bëhet fjalë për përfaqësim në KPF dhe shtoi se nëse ministria gjegjëse konstaton se kësaj partie nuk i takon që ketë anëtarin e saj në Komitetin për Politikë dhe Financa, atëherë ata do ta respektojnë një vlerësim të tillë dhe kjo nuk do të shkaktojë kurrfarë problemi. Në fund sqaroi se LB është subjekt politik me vete e cila e ka identitetin e saj dhe përcaktimin politik, e që i bie se nuk ndodhet nën shtetullat e asnjë partie tjetër politike.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit – tha se qëndroj pas asaj që e thanë parafolësit e mi, sa i përket përfaqësimit të PDK-së në këtë komitet, mirëpo unë dola këtu për të diskutuar më tepër lidhur me përfshirjen e gjinisë femërore në këtë rast. Kisha dashur që secili të kuptojë drejt se Ligji për Barazinë Gjinore është ligj për të dy gjinitë dhe nuk është vetëm për gjininë femërore, siç po e marrin shumica. Sipas saj, në këtë komitet është dëmtuar gjinia femërore. Prandaj, ajo tha që i thërret të gjithë që të mos diskutohet, që të zbatohet apo moszbatohet ligji, sepse pasi që ne si organ ligjvënës nuk i zbatojmë ligjet, atëherë kush po presim që t'i zbatojë ato ligje që dalin nga kuvendi. Ajo bëri thirrje nga të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, e në veçanti nga femrat-anëtare të kuvendit të komunës, pa dallim partie që të kërkojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në KPF.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – propozimi për themelimin të KPF-së, atëherë ishte që për mosbllokim të procesit t'i japim ne dy emra dhe për shkak se nuk ishim të sigurt lidhur me çelësin e saktë, dhe propozimi ishte që të bëhet kërkesë në MAPL lidhur me numrin e anëtarëve të KPF-së. Kështu që unë pata kërkuar që të shtyhet themelimi i KPF-së, i cili shtoi se kishte besuar tek kryesuesi i kuvendit që kjo kërkesë do të bëhej në MAPL. Mirëpo, edhe nëse tash bëhet kjo kërkesë, nuk ka asgjë të keqe, ku tha se nëse MAPL vlerëson se grupit kuvendar të PDK –së i takojnë tre përfaqësues në Komitetin për Politikë dhe Financa, atëherë nevojitet ndryshimi i këtij vendimi.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës, dhe për këtë pikë të kërkohet interpretimi zyrtar i MAPL-së edhe për kuotën gjinore edhe për përbërjen e komitetit.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit – kërkoi sqarime se në rastin konkret a kemi kërkesë për interpretim për çelësin e themelimit të komitetit apo për kuotën gjinore.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës ligjore - tha se kërkesa e MAPL-së është që të respektohen dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore për kuotën e 50%, ndërsa bëri të ditur se vendimi për themelimin e KPF-së nuk është anuluar nga MAPL-ja, tani mbetet në kompetencën e kuvendit se a do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara apo jo.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – propozoi që të votohet vetëm për kuotën gjinore, kurse sa i përket çelësit ceku se grupi kuvendar i PDK-së mund të kërkojë interpretim ligjor nga ministria gjegjëse.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se nuk është mirë që kështu të sprovohemi dhe shtoi se është e drejtë e secilit grup kuvendar që të kërkojë interpretim ligjor sa i përket asaj se me nga sa vende kanë të drejtë të përfaqësohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket përbërjes së komitetit sipas mendimit të Zyrës ligjore gjithçka është në rregull, kurse kur bëhet fjalë për kuotën gjinore, atëherë duhet të gjendet zgjidhja mes AAK-së dhe LB-së e jo kështu të shkojmë deri në pafundësi.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për çelësin e themelimit të KPF-së kjo çështje nuk është në dorën e kuvendit, por i takon subjektit politik PDK. Mandej obligim ligjor është që kryesuesi i kuvendit të kërkojë interpretim ligjor me kërkesën e grupit kuvendar të PDK-së. Pastaj sa i përket kuotës gjinore edhe nëse merret vendim ndryshe ata prapë do të bëjnë kërkesë për zbatimin e ligjshmërisë sa i përket Ligjit për Barazi Gjinore. Tutje shtoi se në rend të ditës është kërkesa e ministrisë për respektim të ligjit sa i përket kuotës gjinore, kurse sa i përket numrit të anëtarëve të KPF-së ata si grup kuvendar do t'i adresohen ministrisë së linjës për të marrë mendimin e tyre. Në fund tha se në të kaluarën PDK ka respektuar kuotën gjinore sa i përket përbërjes së KPF, kurse subjektet tjera politike iu është dashtë të bëjnë zëvendësimin e anëtarëve të tyre në KPF, pasi një gjë të tillë e kishte kërkuar MAPL-ja.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se gjithçka është e qartë pas mendimit të dhënë nga Zyra ligjore, andaj propozoi që të bëhet respektimi i kuotës gjinore.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se ai nuk dëshiron të bëjë lojë politike me subjektin e tij politik, ku vlerësoi se kuvendi le të merret me çelësin për themelimin e komitetit dhe nëse vlerësimi i ministrisë është që grupit të PDK-së i takojnë tri vende në KPF, atëherë a është e gatshme që LDK të bëjë kompromis që t'ia lirojë vendin anëtares së LB-së në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - konstatoi se vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbetet në fuqi, dhe se kuvendi nuk gjeti modalitet për përfshirjen e kuotës prej 50%, sa i përket aspektit gjinor, ndërsa lidhur me çelësin për themelimin e KPF-së, grupi kuvendar i PDK-së i mbetet që të kërkojë interpretim ligjor në MAPL.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - duke iu referuar kësaj pike të rendit të ditës propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018, ceku se është parë se ka suficit të mjeteve në vlerë prej 9.90,960 €. Tek bartja e mjeteve të pashfrytëzuara është paraparë që 4000 € të ndahen për ndërtimin e fushave sportive. Nevoja për terrene rekreative në shkollat fillore është dukshëm e madhe sidomos në fshatrat, duke mbetur gjithmonë inferior. Rast konkret kemi shkollën “Martirët” në fshatin Reznik, e cila prej ndërtimit të saj tash e sa vite nuk ka mundur të ketë një të tillë. Me kërkesë nga banorët e fshatit, prindërit e nxënësve si dhe mësimdhënësit është arritur marrëveshje që prona e Besim Mustafës (banor i fshatit) ka shprehur vullnet që të ua kalojë në pronësi për shfrytëzimin e një terreni sportiv. Me këtë kërkesë ajo propozoi që këto mjete minimale të shpenzohen në ndërtimin e një fushe rekreative në shkollën e fshatit Reznik. Beson që kjo kërkesë ngërthen në vete nevojën, racionalitetin sepse sporti dhe kultura që është kultivuar në rrethinën e Artakollit gjithmonë ka bartur vlera në qytetin e Vushtrisë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se në kuadër të hyrave të bartura nuk mund të futen projekte të reja, për shkak se këtë nuk e lejojnë ligjet në fuqi. Tutje shtoi se me këtë bartje të mjeteve duhet të vazhdohen projektet e mbetura në gjysmë. Andaj vlerësoi se paraprakisht duhet të bëhen analizat e duhura që ligjërisht të jemi në rregull para se të votojmë një vendim të tillë që më vonë mos të kthehet si i kundërligjshëm ky vendim. Pastaj vlerësoi se është mirë që të ngritën subvencionet në vlerën prej 55.000.00 €, por edhe këtu ka mundësi që vendimi të kthehet nga ana e ministrisë për shkak se limiti i subvencioneve përcaktohet nga ministria gjegjëse për financa, për shkak se në këtë rast sikur po e vejmë në lajthitje Ministrinë e Financave, dhe pastaj mund të kemi vonesa për realizimin e projekteve kapitale. Në fund tha se si grup kuvendar do ta mbështesin këtë propozim-vendim, dhe e përgëzon qeverinë e kaluar për inkasimin dhe alokimin e buxhetit për vitin 2018 si një buxhet zhvillimor.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - sqaroi se në këtë rast kemi të bëjmë me tepricë të mjeteve po në këto projekte dhe tani duhet të emërtojmë me kode të reja ekonomike. Kurse sa i përket

subvencioneve janë duke bërë përpjekje që ato t'i rritin në vlerë që është paraparë në propozim-vendim.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se në parim do ta mbështesin këtë propozim, porse futja e projekteve të reja në kuadër të bartjes së mjeteve financiare e rrezikon që ministria gjegjëse ta kthejë këtë vendim si të kundërligjshëm.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditë rendit të ditës kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje.....	1,253.99 €
1.2 Mallra dhe shërbime.....	91,427.70 €
1.3 Shpenzime komunale.....	21,640.12 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	55,000.00 €
1.5 Investime kapitale.....	821,639.11 €

Totali i mjeteve të bartura990,960.92 €.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

5.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se në parim e mbështesin këtë propozim-vendim, mirëpo propozoi që tek pozicioni “ndihmë për zahire” vlera prej 2000 € është shumë e vogël dhe kjo duhet të ngritet ashtu që kësaj vlere t'i shtohen edhe 8000 €, ku këto mjete do të merreshin nga pozicioni “financimi i OJQ-ve.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se Rregullorja për ndarjen e subvencioneve është e planifikuar në Planin e punës të kuvendit dhe e njëjta do të duhej të sillej në kuvend, lidhur me këtë ai propozoi që të bëhet një racionalizim në ndarjen e mjeteve subvencione për shërim, pasi që mjetet po ndahen në shuma të mëdha dhe kështu në dy apo tre muajt e parë të vitit po mbesim pa asnjë mjet financiar lidhur me këtë kategori dhe kjo është shumë keq.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke iu përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditë rendit të ditës kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet ndarja e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018, në bazë të pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1. Në Zyrën e Kryetarit, subvencione ndahen si vijon:

1.1.1 Subvencione për dekorata.....	3.000.00 €
1.1.2 Subvencione për raste të veçanta.....	3.000.00 €
Gjithsej.....	6000.00 €

2. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale subvencionet ndahen për këto kategori:

2.1 Ndhimë me zahire familjeve skamnore.....	2.000.00 €
2.2 Ndhimë për strehim – qiratë.....	24.000.00 €
2.4 Ndhimë për shërim.....	24.000.00 €
2.5 Bashkëfinancim me donatorë për familjet e pastrehë.....	10.000.00 €
2.5 Financim të OJQ-ve.....	25.000.00 €
Gjithsej.....	85.000.00 €

3. Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, subvencionet ndahen për këto kategori:

3.1. Botimi i librave, publikimeve.....	2.000.00 €
3.2. Teatri i qytetit.....	7.500.00 €
3.3 Financimi i OJQ-ve.....	49.414.00 €
Gjithsej.....	58.914.00 €

4. Në Drejtorinë për Arsim, subvencionet ndahen për këto kategori:

4.1. Bursa për studentë.....	18.460.00 €
4.2. Përkrahje e nxënësve dhe studentëve për aktivitete të lira.....	5.540.00 €
4.3. Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.....	9.000.00 €
Gjithsej.....	33.000.00 €

Totali.....182.914.00 €

5. Mjetet e bartura (subvencionet) nga viti 2017.....55.000.00 €

6. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare të dedikuara për subvencione për vitin 2018, që janë shpërndarë nëpër drejtori komunale është.....**237.914.00 €**

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorja për Arsim, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - njoftoi se në këtë trup të kuvendit është propozuar ndryshimi i një anëtari të kuvendit ku në vend në të Radovan Petroviqit do të jetë Milena Aritanoviç dhe kjo është bërë për shkak të kuotës gjinore. Pastaj ai propozoi edhe përbërjen e këtij komiteti nga subjektet politike ku përfaqësimi duhet jetë me nga një anëtar nga PDK-ja një nga LDK-ja, një nga AKR-ja dhe një anëtar nga NISMA.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se edhe më herët në takim me shefat e grupeve kuvendare kishte njoftuar se nuk pajtohen me këtë çelës për themelimin e Komitetit për Komunitete, për faktin se si subjekt politik me 30.74 % të votave në zgjedhjet e fundit e që koeficienti është 1.53 e që në këtë rast PDK-së i takojnë dy anëtarë në Komitetin për Komunitete. Në fund njoftoi se edhe këtë vendim do ta apelojnë në ministrinë kompetente.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se nuk e konteston themelimin e këtij komiteti, porse shtoi se procesverbalet me të cilat janë propozuar anëtarët e këtij trupi nuk ka qenë nevoja që të dërgohen në kuvendin e komunës. Pastaj ai shtroi çështjen e legjitimitetit të këtyre emrave pasi që disa prej emrave i ka përcaktuar një parti politike dhe dihet se një komunitet është më i madh se një parti politike dhe kështu nuk ka objektivitet në caktimin e këtyre anëtarëve.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit – kërkoi që edhe nga radhët e AAK-së të këtë anëtarë në Komitetin për Komunitete.

Në vazhdim kuvendi i komunës me 18 vota “për”, 10 vota “kundër”, të tjerat abstenim aprovoi çelësin e themelimit të Komitetit për Komunitete në këtë përbërje: 1 anëtar nga PDK, 1 anëtar nga LDK, 1 anëtar nga AKR, anëtari i kuvendit nga NISMA, si dhe anëtari i kuvendit nga komuniteti serb.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - propozoi Gentiana Ramën, për anëtare të Komitetit për Komunitetet nga radhët e LDK-së.

Fakete Dushi, anëtare e kuvendit - propozoi Abdulla Vojvoden nga NISMA që të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së njoftoi se nuk do të japin propozimet për këtë komitet dhe për këtë do ankohen në ministrinë gjegjëse kompetente.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit - propozoi Fakete Dushin për anëtare të Komitetit për Komunitete.

Pas dhënies së propozimeve nga anëtarët e kuvendit lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete, kuvendi me 19 vota për“, 8 vota “kundër”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.1 Genta Rama, anëtare e kuvendit (LDK);
- 1.2 _____ anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.3 Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit (NISMA);
- 1.4 Fakete Dushi, anëtare e kuvendit (AKR);
- 1.5 Miljan Bojković anëtar i kuvendit (komuniteti serb);
- 1.6 Milena Aritanović, anëtar (komuniteti serb);
- 1.7 Berat Maxhuni, anëtar (komuniteti turk);
- 1.8 Adem Hoti, anëtar (komuniteti ashkali);
- 1.9 Xhemo Emini (komuniteti rom).

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi Agim Bregajn dhe Shkelzen Fekën për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, kurse nga ekzekutivi komunal është propozuar Sedat Rashica.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se edhe mandatin e kaluar ky komision në përbërjen e tij ka pasur një anëtar nga partia në pushtet, anëtari tjetër nga opozita, ndërsa anëtari tjetër nga

ekzekutivi. Pastaj vlerësoi se një përzgjedhje e tillë është në kundërshtim të plotë me Ligjin mbi Shoqëritë Aksionare, andaj njoftoi se nëse kështu veprohet ata do t'i përdorin të gjitha instrumentet ligjore për ta kontestuar këtë vendim.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “për” 2 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen rajonale të mbeturinave „Uniteti” Sh. A. Mitrovicë, për Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:

1.1 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);

1.2 Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit (LDK);

1.3 Sadat Rashica, anëtar i ekzekutivit.

2. Komisioni komunal i aksionarëve, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe akteve tjera juridike në fuqi, me të cilat është rregulluar kjo çështje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike.

8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen në shëndetësi

Gentiana Rama, anëtare e kuvendit – tha se me kujdes e ka lexuar planprogramin për shëndetësi, andaj ka disa propozime për përmirësimin e gjendjes së sistemit shëndetësor parësor në Komunën e Vushtrrisë. Disa prej rekomandimeve kanë dal nga Akademia e Grave për Leadership në vitin 2017, ku pjesë e hulumtimit ka qenë edhe qyteti i Vushtrrisë. Sistemi shëndetësor në Komunën e Vushtrrisë ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. Një prej pengesave që qytetarët kanë shprehur është marrëdhënia jo e duhur mes ofruesve të shërbimeve mjekësore dhe pacientëve. Shumë pak qytetarë kanë njohuri mbi ekzistencën e kutive të ankesave apo kanë raportuar për parregullsi në sistemin parësor shëndetësor tek institucionet relevante. Kjo gjë ndikon drejtpërsëdrejti në mungesë të qasjes dhe në trajtim të dinjitetshëm të qytetarëve në shëndetësi, ashtu siç atyre u garantohet me ligj. Një prej sfidave tjera është edhe mungesa e barërave nga lista esenciale dhe materialit shpenzues, si dhe mungesa e mjeteve mjekësore për ushtrimin e dinjitetshëm të profesionit. Qytetarët shpesh detyrohen që vet të bëjnë blerjen e produkteve edhe pse ato do të duhej të ishin të disponueshme përmes listës esenciale të barërave. Sfidë tjetër është se në QMF dhe AMF ka mungesë të stafit teknik. Për pasojë, në këto institucione shëndetësore, shpeshherë duhet që infermierët të merren me higjienën, mirëmbajtjen dhe ngrohjen e objekteve. Angazhimi i infermierëve në detyra që nuk përkojnë me punën e tyre, mund të ndikojë në uljen e performacës të punës, si dhe në uljen e ofrimit të shërbimit cilësor për qytetarët. Rast konkret është QMF-ja në Dumnicë të Mesme po besoj që kjo gjendje është edhe në AMF dhe QMF të tjera! Duke u bazuar në këto sfida, konsiderojmë se komunat mund të miratojnë një numër politikash dhe masa afirmative me qëllim të ofrimit të qasjes së duhur në kujdesin parësor shëndetësor për qytetarët e tyre. Këto politika mund të ndahen në: politikat në përmirësimin e marrëdhënies së qytetarëve me ofruesit e shërbimeve në nivelin parësor; trajnime shtesë për stafin profesional; drejtorët e QKMF-ve në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë të komunave mund të organizojnë trajnime në bashkëpunim me Odat e Professionistëve Shëndetësor për stafin profesional mbi etikën e punës dhe krijimin e marrëdhënies me të mira me pacientë, ashtu siç kërkohet në bazë të Ligjit për

Odat e Profesionistëve Shëndetësor, si dhe Udhëzimit Administrativ 02/2015 neni 17 mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm Shëndetësor Profesional. Po ashtu, me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcaktohen kompetencat e komunave në ç' rast ato obligohen që ndër të tjera të punojnë edhe në ofrimin e përkujdesit publik parësor shëndetësor. Krijimi i kushteve të përshtatshme për personelin dhe pacientët, përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryetarët e komunave duhet të bëjnë presion në nivelin qendror që të rritet buxheti për shëndetësi për nivelin lokal, në mënyrë që të përmirësohet qasja në kujdesin shëndetësor parësor. Rritja e buxhetit do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e shërbimeve shëndetësore përmes rritjes të numrit të stafit mjekësor, stafit ndihmës, furnizim me mjete të punës dhe pajisjet mjekësore dhe ka mungesë të stafit mjekësor, drejtoritë komunale për shëndetësi mund ta kontraktojnë shërbimin e higjienës për të mundësuar rritjen e numrit të stafit mjekësor. Krijimi i ekipeve mobile: Drejtoria e Shëndetësisë në komunat me më pak se 150 mijë banorë, ku nuk të rrisin numrin e stafit mjekësor në AMF dhe QMF, duke qenë se në shumicën e QMF-ve dhe AMF ekzistojnë Qendrat e Mjekësisë Urgjente, të krijojnë ekipe mobile në gatishmëri, të cilët do të ishin në shërbim të qytetarëve që jetojnë në zona më të largëta dhe që qasjen në institucione shëndetësore të nivelit parësor e kanë të kufizuar. Politika në ngritje të transparencës përmes raportimit të parregullsisve në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor; vizita më të shpeshta në QMF dhe në AMF, dhe për të adresuar këto çështje, do të ishte e nevojshme të bëhen vizita më të shpeshta në qendrat e mjekësisë familjare dhe në ambulancat e mjekësisë familjare për t'u siguruar se stafi i angazhuar e respekton orarin. Këto vizita duhet të realizohen nga personat e autorizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë në komunat përkatëse. Funksionimi i komiteteve etiko-profesionale: në kuadër të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale duhet të fuqizohet funksionimi i komiteteve etiko-profesionale të përbëra nga drejtorët e shëndetësisë në komunë, nga stafi i Qendrës kryesore të mjekësisë familjare, si dhe një përfaqësues nga shoqëria civile, e të cilët do të shqyrtojnë shkeljet e mundshme të kodit të etikës dhe më pas të ndërmarrin masa disiplinore në pajtim me rregulloret e punës. Fushata vetëdijesuese me qytetarët: ngritja e vetëdijes së qytetarëve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përmes takimeve të vazhdueshme për t'i vetëdijësuar mbi Ligjin për Shëndetësi, si dhe kartën e drejtave të pacientit. Kjo mund të arrihet përmes implementimit të Strategjisë për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë, takimeve të rregullta me qytetarë, fushatave vetëdijesuese dhe bashkëpunim me shoqërinë civile. Krijimi i komisioneve për shqyrtim të ankesave: të krijohen dhe të funksionalizohen komisionet për trajtimin e ankesave të pranuar në institucionet shëndetësore të sistemit parësor. Përveç kësaj, drejtoritë e komunave mund të përdorin teknologjinë moderne për të ngritur transparencën dhe kjo mund të bëhet përmes dizajnit të platformave specifike për komunën, ku qytetarët mund të dërgojnë ankesat e tyre online. Verifikimi i këtyre ankesave të bëhet nga një përfaqësues i QKMF-së, Drejtorisë së Shëndetësisë, një qytetar dhe një përfaqësues i shoqërisë civile dhe të veprohet menjëherë pasi të analizohet ankesa. Raportime më të shpeshta në kuvend: drejtoritë komunale për shëndetësi duhet të përpilojnë raporte të detajuara tremujore mbi gjendjen e shëndetësisë në komunë, raporte të cilat do të paraqiten para asamblistëve të kuvendit komunal. Politika për planifikim të bazuar në nevojat reale në komuna në mënyrë që ofrimi i shërbimeve gjatë qasjes në kujdesin shëndetësor të jetë në pajtim me nevojat e komunitetit. Furnizim përmes të hyrave vetanake: në rastet kur komuna ka mungesë të ndonjë medikamenti specifik nga lista esenciale dhe materialet shpenzuese, atëherë Drejtoria e shëndetësisë mund të shfrytëzojë buxhetin nga të hyrat vetanake të komunës në mënyrë që të ofrohet qasja e duhur dhe shpërndarja e barërave të bëhet në mënyrë të rregullt për pacientët (si shembull mund ta marrim Komunën e Pejës e cila e praktikon tash e 5 vite).

Agron Perçuku, anëtar i kuvendit – tha se në informatë nuk është dhënë asnjë e dhënë lidhur me administratën e shëndetësisë dhe për këtë ai kërkoi të informohet me sa vijon: për atë se përse nuk punon juristi në administratën e shëndetësisë dhe shefi i kontabilitetit, kurse për këtë pyeti se kush e kryen punën në këto pozita. Pastaj pyeti lidhur me licencimin e institucioneve

private shëndetësore se sa janë të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe sa prej tyre punojnë pa licencë.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit - tha se në të kaluarën shëndetësia në komunën tonë nuk ka qenë në prioritet, por tani pas ndërrimit të strukturës qeverisëse, kjo fushë është në prioritet dhe shpreson se në këtë lëmi do të ketë vetëm suksese. Në fund ai u zotua se do të përkrah drejtorin aktual të shëndetësisë.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018

Habibe Gërzhaliu, anëtare e kuvendit -tha se edhe përkundër investimeve të mëdha dhe përmirësimit të gjendjes në arsim, akoma mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim. Pastaj tha se edhe në shkollën ku ajo punon ka pasur investime, por ende ka mungesa me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë, duke filluar nga laboratorët, mjetet e konkretizimit dhe mjetet tjera të punës, mandej mungon ngrohja qendrore dhe rrethoja e oborrit të shkollës. Duke i marrë për bazë të gjitha këto ajo ftoi DA në Vushtrri që ta vizitojë shkollën fillore në fshatin Lumadh dhe të ndikojë në përmirësimin e gjendjes në këtë shkollë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se për ta përmirësuar gjendjen në arsim do të bëjmë përpjekje të gjithë e edhe ata si parti opozitare do japin përkrahjen e tyre. Pastaj ceku se mungesat në shkollat e mesme të larta mesatarja është 15 mungesa për nxënës dhe kjo është një shifër shumë e lartë e mungesave. Pastaj ai bëri vërejtje se në DA nuk sjellet raporti për mungesat e mësimdhënësve në orë. Lidhur me këtë ai njoftoi se në të kaluarën ka ekzistuar një rregullore ku në bazë të saj për çdo orë të humbur mësimdhënësi është sanksionuar me nga 5 €. Pastaj ai vlerësoi dhe apeloi tek qeveria aktuale që punësimet që do t'i bëjë në lëmin e arsimit mos t'i bëjë sa për ti rahatuar aktivistët, por t'i punësojë ata të kualifikuarit dhe rekrutimi të bëhet konform udhëzimeve administrative.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – pasi e mbështeti konstatimin e znj. Habibe Gërzhaliu lidhur me mungesën e kushteve në shkollën në fshatin Lumadh, shtoi se në vitin e kaluar janë shpërndarë disa laptopë nga DA në Vushtrri, për nevojat e shkollave dhe ka informacione se ata laptopë janë shpërndarë pa ndonjë kriter të caktuar dhe shumë shkolla të cilat kanë qenë të pajisura edhe me kabinete edhe me kompjuterë janë pajisur me këta laptopë, kurse shkollat e tjera të cilat nuk kanë kabinete të informatikës e as kompjuterë kanë mbetur pa u pajisur. Lidhur me këtë ai pyeti se cilat kanë qenë kriteret për ndarjen e këtyre laptopëve. Në vazhdim ai njoftoi kuvendin dhe informoi edhe prindërit e nxënësve të shkollës “Naim Frashri”, të cilët mësimin e mbajnë në shkollën e mesme “Bahri Haxha” se kushtet në këtë shkollë janë në nivel shumë të mirë. Tutje vlerësoi se në shkollën profesionale “Bahri Haxha” është investuar shumë dhe tani mund të thuhet se kjo shkollë i plotëson të gjitha kushtet, por këtyre investimeve sikur po iu humbet vlera dhe pamja për shkak të rrugës që është në oborrin e shkollës e cila fillon nga dera e oborrit dhe përfundon në hyrje të shkollës, andaj kërkoi që kjo rrugë të futet në projekt dhe të rregullohet sa më parë. Mandej ai e përgëzoi DA-në për hartimin e një raporti profesional dhe të krahasueshëm me vitin e kaluar dhe në tërësi për punën që është duke e bërë. Duke dashur të shprehë brengjen e tij ceku se gushtin e vitit të kaluar Komuna e Vushtrrisë ka lidhur një marrëveshje me OJQ “Smart” për punësimin e disa pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkollat e komunës. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar pa e ditur gjendjen financiare të kësaj organizate dhe pa e ditur prejardhjen e financimit të kësaj organizate, pa kriteret dhe me shumë parregullsi janë punësuar 110 mësimdhënës, kryesisht pedagogë dhe psikologë që kanë punuar për afro dy muaj dhe në fund ata nuk e morën kompensimin e tyre. Përkundër pompozitetit që iu dha sidomos në fushatën zgjedhore në fund doli se krejt kjo ishte mashtrim nga qeveria e kaluar dhe me këtë u cenua integriteti profesional i këtyre mësimdhënësve. Ky informacion apo e dhënë është dashur të futet në këtë raport të Drejtorisë

së Arsimit. Në fund pyeti se mashtruesit të OJQ-së të quajtur “Smart” a iu është hapur ndonjë proces gjyqësor për marrëveshjen e tillë mashtruese që kanë lidhur me Komunë e Vushtrrisë. **Afrim Namani, drejtor i DA-së** - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, dha sqarime dhe u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

10. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Këshillit për Siguri në Bashkësi

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

1.1. Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – kryesues;

1.2. Muhamet Alidemaj, komandant i stacionit policor – anëtar;

1.3 Afrim Namani, drejtor për arsim – anëtar;

1.4 Bajrush Kosumi, drejtor për mbrojtje dhe shpëtim – anëtar;

1.5 Bajram Kela, përfaqësues i FSK-së – anëtar;

1.6 Hadije Zuqaku, kryetare e Këshillit të prindërve të arsimit të komunës – anëtare;

1.7 Remzije Zekolli, zyrtare për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut – anëtare;

1.8 _____ kryesues i Komitetit për Komunitete – anëtar;

1.9 Shemsi Rrahimi, përfaqësues i Bashkësisë islame në Vushtri - anëtar;

1.10 Simo Çimburovic, përfaqësues i kishës ortodokse serbe – anëtar;

1.11 Banush Elezi, përfaqësues i kishës protestante ungjillore – anëtar

1.12 Nebojsha Zdravković, përfaqësues i komunitetit serb – anëtar;

1.13 Lutfije Haxhiu, përfaqësuese e komunitetit turk – anëtar;

1.14 Valdet Zymeri, përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;

1.15 Adnan Hodiq, përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;

1.16 Ismet Saraçi, anëtar i Këshillit lokal për siguri në bashkësi, për fshatrat: Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Beçuk dhe Mihaliq – anëtar;

1.17 Fatmir Feka, kryesues i Këshillit komunal për siguri në bashkësi, për fshatrat: Banjskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërlllobuq, Karaçë, Begaj, si dhe BL “Kalaja” Vushtri – anëtar;

1.18 Tafil Hyseni, kryesues i Ekipit veprues për siguri në bashkësi – anëtar;

1.19 Branislav Vuksanoviq, përfaqësues i Zyrës komunale për komunitete dhe kthim – anëtar;

1.20 Drita Dibrani, përfaqësuese nga OJQ – anëtar;

1.21 Avni Deliu, përfaqësues i mediave lokale – anëtar;

1.22 Ibrahim Novolani, përfaqësues i komunitetit të biznesit – anëtar;

1.23 Isak Hyseni, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta – anëtar.

2. Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre do t'i ushtrojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MPB-së Nr.27/12 dhe MAPL-së Nr.03/12 për themelimin e KKS-së.

3. Mandati i KKS-së është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës.

4. Anëtarët e KKS-së, për pjesëmarrje në mbledhje kompensohen në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) dhe vetëm për 6 (gjashtë) mbledhje të mbajtura brenda vitit kalendarik.

5. Shërbyesit civil, të cilët marrin pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës, nuk kanë të drejtë të kompensimit të mëdijëve për pjesëmarrje në mbledhjet e KKS-së.

6. Në rast se anëtari /ja i/e KKS-së, nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi ose për çfarëdo sjellje apo veprim e komprometon funksionimin efektiv të KKS-së, me propozimin e kryesuesit të KKS-së, Kuvendi i komunës emëron anëtarin tjetër të këtij këshilli.

b). Shqyrtimi i propozimit për formim të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Agron Përçukun për anëtar të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - nga opozita propozoi Ermal Lahun për anëtar të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Gresa Mulin për anëtare të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim, formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në këtë përbërje:

1.1 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit (LDK);

1.2 Gresa Muli, anëtare e kuvendit (LVV);

1.3 Ermal Lahu, anëtar i kuvendit (PD);

1.4 Rexhep Gërguri, ekonomist - nga ekzekutivi i komunës

1.5 Berat Sadiku, inxh. i arkitekturës – nga ekzekutivi i komunës

1.6 Adnan Lahu, ekonomist - nga ekzekutivi i komunës

1.7 Isak Hyseni ekspert - nga shoqëria civile.

2.Mandati i komisionit është i njëjtë me mandatin e tanishëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

3.Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin kryesuesin e komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

4.Komisioni në përbërje të cekur si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores së QRK, Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe anëtarët e komisionit vlerësues; Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural; Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Zyra ligjore.

c).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formim të Komisionit për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Teuta Aruqi Shartari, anëtare e kuvendit - propozoi Basri Menxhiqin, për anëtar të komisionit, nga radhët e AAK-së.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi Ymer Haradinajn për anëtar të komisionit.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi Sami Istrefin për anëtar të komisionit.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - në emër te grupit kuvendar të LDK-së propozoi Arta Imerin për anëtare të komisionit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim, formohet Komisioni për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në këtë përbërje:

- 1.1 Sami Istrefi, anëtar (PDK);**
- 1.2 Ymer Haradinaj, anëtar (LVV);**
- 1.3 Arta Imeri, anëtare (LDK);**
- 1.4 Basri Menxhiqi, anëtar (AAK);**
- 1.5 Idriz Muzaqi (Zyra ligjore).**

2.Mandati i komisionit është i njëjtë me mandatin e tanishëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

3.Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin kryesuesin e komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

4.Komisioni në përbërje të cekur si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores së QRK,

Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe anëtarët e komisionit.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se edhe në fillim të mbledhjes kërkoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, për faktin se ajo është sjellë në kuvend e papërgatitur mirë, pasi këtij propozim-vendimi i mungojnë certifikatat e pronës dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm, mandej se në dy zona kadastrale kemi të bëjmë me prona nën masën e komasacionit dhe kështu që para se kuvendi të votojë, duhet që kjo çështje të analizohet mirë dhe të heqim çdo dilemë. Në fund tha se si LB nuk janë kundër që këto prona të jepen në shfrytëzim, por tha se duhet të jemi të kujdesshëm sepse në fund kryesuesi i kuvendit nëse diçka nuk shkon si duhet mund të jap përgjegjësi ligjore.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se do ta votojë këtë pikë të rendit të ditës, për faktin se është shumë me rëndësi që këto trafo të instalohen në terrenet ku ato janë planifikuar të instalohen.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se edhe nga takimet e kaluara që ka pasur me KEDS-in, ka kërkuar që urgjentisht të intervenohet në rrjetin elektrik të zonës së Çiçavicës, për faktin se ka shumë mungesa në rrjet. Tutje njoftoi se KEDS-i për këtë vit ka gjithsej 16 projekte për Komunën e Vushtrrisë, ku prioritet do t'i jepet Çiçavicës, për shkak se është emergjente të intervenohet në rrjetin elektrik të këtij rajoni. Plani investiv i KEDS-it ekziston në Drejtorinë e Urbanizmit dhe si kryetar i komunës është duke bërë përpjekje dhe shpreson tek KEDS-i, që kabllot elektrike në sheshin e qytetit të hiqen nga aty dhe të vendosen në vendin adekuat.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se vendosja e këtyre trafo-stacioneve është tepër imediate për faktin se këto ndihmojnë dhe nevojiten për ndërprerjen e rrymës gjatë defekteve, dhe për këtë mundësohet që në një pjesë të ndërpritet energjia elektrike derisa të evitohet ai defekt, kurse pjesa tjetër do mund të kishte energji elektrike. Pastaj shtoi se në rrjet kemi mjaft mungesa dhe ky financim është tepër i mirësearchur dhe deklaroi se do ta mbështesë.

Breat Sadiku, drejtor i DUMM-së - dha sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Isa Latifi, zyrtar i DUMM-së - paraqiti sqarime, duke shtuar se të dhënat që janë paraqitur në propozim-vendim, lidhur me numrat e parcelave, kanë gabime teknike sepse një version i tillë i numrave nuk mund të qëndrojë. Tutje njoftoi se kanë kërkuar nga KEDS-i që projektet e tyre për rrjetin elektrik t'i japin konform gjendjes gjeodezike dhe kadastrale që është në Drejtorinë e Kadastrit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, në lokacionet si në vijim:

- 1.1 Vendosja e katër (4) trafostacioneve të reja, shtyllë – kapriatë në parcelat kadastrale 00398 – 0, Zona Kadastrale Vërrnicë, dhe parcela kadastrale 871 – 1, Zona Kadastrale Vërrnicë, parcela kadastrale 00610 – 0, Zona Kadastrale Vërrnicë, parcela kadastrale 00635 -0, Zona Kadastrale Reznik, parcela kadastrale 00557 -0, Zona Kadastrale Reznik, pronë e Komunës së Vushtrrisë,**

me dimensione prej $3 \times 3 \text{ m}^2$ (9 m^2), e cila përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 36 m^2 .

1.2 Vendosja e dy trafostacioneve të reja, shtyllë – kapriatë në parcelën kadastrale P-263, Zona Kadastrale Pantinë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me dimensione $3 \times 3 \text{ m}^2$ (9 m^2), e cila përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 18 m^2 , pronë e Komunës së Vushtrrisë.

1.3 Vendosja e dy trafostacioneve të reja, shtyllë – kapriatë në parcelën kadastrale P- 407 Z.K Ropicë, pronë e Komunës së Vushtrrisë me dimensione prej $3 \times 3 \text{ m}^2$ (9 m^2) dhe vendosja e një STSH me dimensione $2 \times 6 \text{ m}^2$ (12 m^2), pronë e Komunës së Vushtrrisë.

1.4 Vendosja e dy trafostacioneve të reja, shtyllë – kapriatë në parcelën kadastrale P-244-0 ZK Ropicë, pronë e Komunës së Vushtrrisë me sipërfaqe $3 \times 3 \text{ m}^2$ (9 m^2).

2. Ngastrat kadastrale të cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite KEDS-it për vendosjen e trafostacioneve të reja shtyllë-kapriatë dhe SHTSH me dimensione $2 \times 6 \text{ m}^2$ pa kompensim.

3.Me zbatimin e planeve rregulluese urbane, nga komuna obligohen institucionet, kompania kompetente që të bëjnë dislokimin e stabilimenteve shpërndarëse (blindë) me mjetet e saj përcjellëse, ashtu siç kërkohet nga organi kompetent.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat për të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

d). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – në kuadër të pikës ku parashtrohen pyetjet e anëtarëve të kuvendit, njoftoi se nuk mundi të ishte prezent në fillim të mbledhjes së kuvendit, për shkak se ishte në një takim me zëvendësambasadoren e SHBA-ve, në ç’rast kanë bërë përrurimin e shkollës së mesme “Bahri Haxha”. Në këtë kontekst ai ceku se ishte informuar se në fillim të mbledhjes kishte pasur akuza nga ana e opozitës në adresë të tij e që tani ai dëshiron të japë disa sqarime: lidhur me akuzën për presion dhe kërcënim ndaj shërbyesve civil, ai deklaroi se kushdo që i ka bërë këto akuza është mirë të deklarohet me emër dhe mbiemër se cilin zyrtar të komunës e ka kërcënuar qoftë nga ai apo stafi i tij, për faktin se kërcënimet përbën vepër penale dhe për këtë nëse nuk keni një zyrtar komunal që deklarohet publikisht që ka kërcënime ndaj tij nga kushdo qoftë anëtar i stafit të tij, duke përfshirë edhe atë si kryetar i komunës, atëherë kjo është shpifje e ulët dhe kërkoi që të tërhiqet ose do të ballafaqohet me pasojat ligjore për një shpifje të tillë të ulët. Në anën tjetër u deklarua qartë dhe hapur para kuvendit se Ligji për Shërbimin Civil ka përcaktuar që <shërbyesit civil mund të transferohen për një periudhë një (1) vjeçare në një pozitë të ngjashme, duke mos iu ulur koeficienti edhe pa pëlqimin e shërbyesit civil, ndërkohë që për çdo papërgjegjësi të shërbyesve civil janë të parapara masat disiplinore dhe procedurat për dhënien e masave disiplinore në bazë të Rregullores për masat ndaj shërbyesve civil> dhe me këtë ai e siguroi kuvendin që nuk do të hezitohet që të iniciojë masa disiplinore kurdo që kemi papërgjegjshmëri ndaj qytetarëve. Pastaj vlerësoi se ai ka një

mandat katër (4) vjeçar që ka marrë nga qytetari i Vushtrisë për të udhëhequr me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi e llogaridhënie para qytetarëve, katër vite pas sot ai do të dalë para qytetarëve do të ballafaqohet me vendimet e tij dhe veprimet e tij. Mandej tha se nuk do të lejojë që zyrtarët e komunës të mbrojnë më tepër palët dhe jo të interesin e komunës dhe me këtë njoftoi se pothuaj çdo kontratë që është lidhur deri me tani për dhënien e pronës në shfrytëzim më tepër është mbrojtur interesi i qiramarrësit se sa interesi i qiradhënësit (e që në këtë rast është komuna). Në këtë kontekst detyrë parësore e këtyre zyrtarëve ka qenë mbrojtja e interesit të komunës e jo të mbrohet interesi i atyre personave që i kanë marrë me qira ato parcela. Në këtë kuadër njoftoi se ka anuluar pesë kontrata për dhënien e pronës në shfrytëzim në oborrin e Kalasë dhe kjo çështje ka qenë publike, në këtë rast tri herë kishte kërkuar raport nga zyrtari përgjegjës dhe në të tri herët ka dështuar që të ta njoftojë se qiramarrësi brenda pesë ditëve kishte dështuar të marrë lejen ndërtimore, tri raporte me shkrim i kishte kërkuar dhe në të tri rastet nuk është raportuar se përse pala nuk kishte filluar brenda afatit prej pesë ditëve me procedurën për marrjen e lejes ndërtimore ashtu siç ishte paraparë me kontratë, dhe vlerësoi se çfarë duhet të bëjë ai si kryetar i komunës në këtë rast, t'i thotë zyrtarit vazhdo duke mbrojtur interesin e palës. Lidhur me këto apeloj që kushdo që ka një dëshmi konkrete që ndokush nga stafi i tij i është kërcënuar cilido zyrtar komunal për këtë urdhëroni dilni në foltore dhe deklaroni publikisht para të gjithëve me emër dhe mbiemër për këto kërcënime sepse përsëriti se kërcënimi paraqet vepër penale, në të kundërtën nëse nuk kanë dëshmi, atëherë kërkoi që ata që i bënë këto akuza të dalin ta tërheqin fjalën e tyre dhe publikisht të kërkojnë falje.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se kritika e tij ka të bëjë me heqjen e fotografisë së Presidentit të Republikës së Kosovës nga zyra e Kryetarit të Komunës së Vushtrisë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se fotografinë e Presidentit të Republikës nuk e ka hequr nga zyra, por e ka spostuar në një vend tjetër, ajo qëndron në zyrën e kryetarit të komunës ashtu siç e përcakton Ligji për Protokollin e Shtetit.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – tha se ka pritur që kryetari i komunës të jetë aty në mbledhjen e kuvendit që ta dëgjojë diskutimin e tij, sepse siç tha ai nuk e ka frikën e ballafaqimit, mandej shtoi se e njeh mirë kryetarin e komunës i cili gjatë fushatës zgjedhore ka bërë shpifje ndaj tij dhe familjes së tij, dhe për këtë kurrë nuk i kishte kërkuar llogari andaj ceku se nëse dëshiron që t'i qasen rrugëve ligjore dhe institucionale tha se duhet prituri vetëm edhe pak në muajt në vijim ku do të jetë gati të ballafaqohet në çdo mënyrë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – përsëriti se parafolësi kishte thënë se ai apo stafi i tij ka kërcënuar punëtorët e komunës, andaj për këtë kërkoi që të deklarohen emrat se kush është kërcënuar dhe nga kush është kërcënuar dhe jo vetëm të flitet në mënyrë paushalle, sepse kështu është duke u keqpërdorur foltorja e kuvendit, dhe këtë nuk do ta lejojnë, pasi që po bëhen akuza të pabaza. Tutje shtoi se është në komunë për ta parandaluar krimin dhe për të vendosur rend dhe ligj, në këtë rast ceku se njëqind (100) mësimdhënës janë keqpërdorur me projektin “Smart”, është lejuar të dhunohen nxënësit tanë dhe prindërit e tyre nga një qeverisje e kaluar e papërgjegjshme që ka lejuar të tjerët të fusin duart në arsim çdokush në mënyrë ta paverifikuar. Pastaj kemi një kontratë për rrënimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina”, ndërkaq që për tri vitet e ardhshme planifikimi i mjeteve për këtë projekt nga Ministria e Kulturës është në vlerën zero. Andaj lidhur me këto dhe të tjerat u zotua se do ta ndal krimin dhe korrupsionin, dhe do ta vendosë rendin dhe ligjin, duke shtuar se nuk do të ndalet para askujt që mendon se me të shërbesh në komunë duhet t'u shërbesh interesave të atyre që i kanë paguar deri tash dhe kjo nuk do të lejohet kurrë. Në fund ai tha se do të vazhdojë me përmirësimin e gjendjes dhe vendosjen e rregullit ashtu siç kanë vepruar me laboratorin, me respektimin e orarit të punës, me transparencë në shpenzime dhe llogaridhënie para qytetarëve, kurse ata që kanë qeverisur për 12 vite radhazi para se të bëjnë akuza duhet ta mbajnë kokën ulur për keqqeverisjen e tyre, ndërsa, sa i përket shërbyesit civil duke përfshirë edhe atë si zyrtar i lartë publik do të japin llogari para qytetarëve.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se i vjen mirë që kryetari i komunës po gjen guxim që të akuzojë për 12 vitet e kaluara për keqqeverisje, por për të gjitha këto që thuhet duhet të kenë një adresë dhe adresa është organet përgjegjëse. Sa i përket shërbyesve civil ata e kanë një ligj që i mbron dhe atë ligj nuk e ka shkruar kryetari i komunës e as ai vet, dhe në këtë rast ashtu si iu kanë kërcënuar atij dikur le t'i kërcënohen edhe kryetarit të komunës, por kërcënim me gjuhën e ligjit. Lidhur me zotimet e kryetarit të komunës për ta vendosur rregullin dhe ligjin, ceku se do ta mbështet për ta jetësuar një gjë të tillë. Nëse qeverisja e PDK-së ka bërë shkelje të ligjit, atëherë ato shkelje le të adresohen në organet përgjegjëse kompetente, por jo në emër të ligjit të bëhen shkelje tjera.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – kërkoi nga subjektet politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës që të marrin për bazë rekomandimin e MAPL-së për respektimin e kuotës gjinore sa i përket përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në ora 17:10.

Bastri Duraku

Nasuf Aliu

Procesmbajtës


Kryesues i Kuvendit

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se i vjen mirë që kryetari i komunës po gjen guxim që të akuzojë për 12 vitet e kaluara për keqqeverisje, por për të gjitha këto që thuhet duhet të kenë një adresë dhe adresa është organet përgjegjëse. Sa i përket shërbyesve civil ata e kanë një ligj që i mbron dhe atë ligj nuk e ka shkruar kryetari i komunës e as ai vet, dhe në këtë rast ashtu si iu kanë kërcënuar atij dikur le t'i kërcënohen edhe kryetarit të komunës, por kërcënim me gjuhën e ligjit. Lidhur me zotimet e kryetarit të komunës për ta vendosur rregullin dhe ligjin, ceku se do ta mbështet për ta jetësuar një gjë të tillë. Nëse qeverisja e PDK-së ka bërë shkelje të ligjit, atëherë ato shkelje le të adresohen në organet përgjegjëse kompetente, por jo në emër të ligjit të bëhen shkelje tjera.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – kërkoi nga subjektet politike të përfaqësuara në kuvendin e komunës që të marrin për bazë rekomandimin e MAPL-së për respektimin e kuotës gjinore sa i përket përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në ora 17:10.


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit